



Lidhja Demokratike e Kosovës / Democratic League of Kosova

**PROGRAMI POLITIK**

*I LIDHJES DEMOKRATIKE TË KOSOVËS*

**Për perspektivën evropiane**

Prishtinë,  
mars 2012

*Ky program përmban parimet mbi të cilat mbështetet filozofia e veprimit politik të Lidhjes Demokratike të Kosovës. Këto parime janë frymëzuar nga vlerat dhe përvoja e Lidhjes Demokratike të Kosovës, nga nevojat dhe prioritetet nacionale të Kosovës, si dhe nga parimet e Partive Popullore Evropiane. Ky Program, i aprovuar në Konevntën e Parë të Lidhjes Demokratike të Kosovës të mbajtur në Prishtinë më 3 mars 2012, shërben si bazë për zhvillimin e Programit Qeverisës të Lidhjes Demokratike të Kosovës.*

## Përmbajtja

I.	LIDHJA DEMOKRATIKE E KOSOVËS .....	4
	Preambula .....	4
	Vlerat e lirisë dhe të pavarësisë .....	5
	Kultivimi i vlerave demokratike .....	5
	Vizioni dhe misioni për të ardhmen .....	6
	Objektivat e LDK-së: Kosova evropiane .....	7
	Vizioni human mbi shoqërinë .....	7
II.	REFORMAT DHE MODERNIZIMI I PARTISË .....	9
III.	QEVERISJE NË SHËRBIM TË QYTETARËVE .....	10
IV.	SHTETI LIGJOR .....	12
V.	ZHVILLIMI EKONOMIK .....	13
	Filozofia e LDK-së për zhvillim ekonomik .....	13
	Zhvillimi i sektorit privat .....	14
	Përmirësimi i kornizës ligjore dhe zvogëlimi i burokracisë në raport me bizneset ....	14
	Mbështetja e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme .....	15
	Investimi në kapitalin njerëzor dhe nxitja e inovacioneve .....	15
	Bujqësia, zhvillimi rural dhe turizmi .....	15
	Mbështetja e biznesit për të zvogëluar kostot .....	15
	Politikat tatimore .....	16
	Shpenzimet publike .....	16
	Ndërmarrjet publike .....	16
	Anëtarësimi në organizatat ekonomike ndërkombëtare .....	16
	Energjetika, minierat dhe ruajtja e ambientit .....	17
	Sistem financiar i qëndrueshëm dhe në funksion të zhvillimit ekonomik .....	17
VI.	ARSIMI DHE SHKENCA .....	18
VII.	POLITIKA E JASHTME .....	19
VIII.	PROCESET INTEGRUESE .....	20
	Integrimet evropiane dhe euroatlantike .....	20
	Integrimet shqiptare .....	20
IX.	SHËNDETËSIA .....	21
X.	POLITIKAT SOCIALE DHE SOLIDARITETI NDËRSHOQËROR .....	21
XI.	VLERAT KULTURORE DHE SPORTET .....	22

## I. LIDHJA DEMOKRATIKE E KOSOVËS

### Preambula

*Lidhja Demokratike e Kosovës, LDK, është themeluar (më 23 dhjetor 1989) nga intelektualët shqiptarë të Kosovës, në krye me dr. Ibrahim Rugovën, i cili ka qenë kryetar i saj për të gjallë të tij. Kjo lëvizje shqiptare, me program kombëtar e demokratik, duke e bërë program fundamental politik Lirinë, Pavarësinë e Demokracinë e Kosovës, fitoi përkrahjen dhe mbështetjen e popullit të Kosovës.*

*Në kohën e represionit më të egër serb e jugosllav kundër popullit të Kosovës, LDK-ja organizoi rezistencën politike e qytetare, organizoi jetën sociale, politike e publike, duke promovuar lirinë e fjalës, lirinë e shprehjes, tolerancën e humanitetin, duke promovuar vlerat autentike e universale.*

*Me këto karakteristika të veprimit, LDK-ja fitoi respektin e përgjithshëm në botën shqiptare dhe në botën demokratike perëndimore. Kreu i saj historik, dr. Ibrahim Rugova, me politikën e urtë e vizionare, e bëri LDK-në forcën më të madhe të integriteteve shqiptare, çështjen e Kosovës e bëri çështje me interes evropian e amerikan dhe krijoi miq e aleatë kudo në botën demokratike.*

*Si lëvizje politike kundër dhunës e diktaturës komuniste dhe qeverisjes arbitrare, LDK-ja e promovoi Republikën e Kosovës si shoqëri e shtet të vlerave, me filozofi të integriteteve rajonale e euroatlantike, duke e rikthyer vendin në shtratin kulturor e politik të Perëndimit, si vend evropian.*

*LDK-ja krijoi normën e rregullimit të brendshëm demokratik, ku askush nuk mund të jetë përfaqësues pa qenë i votuar, ku funksionon konkurrenca e lirë e ofertës së vlerave e të programeve, ku bashkohet vullneti dhe jepet përgjegjësia.*

*LDK-ja, që nga fillimi u shfaq si forcë politike institucionale, duke punuar me mund e sakrificë për ndërtimin e institucioneve demokratike të Kosovës, si bazë fundamentale e shtetit, në mënyrë që të mos rrëshqitet në anarki, arbitraritet e diktaturë. Promovimi i votës së lirë dhe përgjegjësia e të zgjedhurit përbëjnë karakteristikën e LDK-së, standard që nuk guxon të shkilet në asnjë situatë.*

*LDK-ja për më tepër se dy dekada ka qenë emblema e shtetndërtimit dhe e demokracisë së Kosovës, si dhe promovuese e vlerave politike e kulturore shqiptare para vetes e para botës.*

*LDK-ja ka dhënë e para kreun e shtetit të Kosovës, Presidentin Historik, dr. Ibrahim Rugovën, të zgjedhur me votë të drejtpërdrejtë.*

*Si parti shtetndërtuese e institucionale, LDK-ja ka organizuar shpalljen e Pavarësisë, aprovimin e Kushtetutës, Referendumin për Pavarësi, ka propozuar shenjat e shtetit të Kosovës, himnin, flamurin, ka nisur përfaqësimin diplomatik.*

*Duke lidhur kohët, traditën dhe modernitetin, duke lëvizur në hap me kohën, tashmë për zhvillimin e gjithmbarshëm të Republikës së Kosovës, LDK-ja me program fundamental dhe në vizionin e Kosovës, mbetet përherë rugoviane, kurse dr. Ibrahim Rugova shenja e saj identifikuese dhe mbrojtëse, ashtu, si dhe shenja e Kosovës së pavarur.*

*Duke i ruajtur dhe kultivuar vlerat bazike dhe simbolet që përcollën veprimtarinë politike e nacionale për liri dhe pavarësi, të drejtuar nga presidenti Rugova, Lidhja Demokratike e Kosovës do të angazhohet që në një të ardhme, me pajtimin e qytetarëve të Kosovës, flamuri i Dardanisë të jetë flamur i Republikës së Kosovës dhe himni i propozuar nga Presidenti Rugova, “Kur ka ra kushtrimi n’Kosovë” të jetë himn i Republikës së Kosovës.*

*Presidenti Rugova proklamoi me vendosmëri një Kosovë të pavarur, të integruar në Bashkimin Evropian dhe në NATO dhe në miqësi permanente me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Kjo kërkesë e Tij, ky vizion politik u bë platformë nacionale e shqiptarëve dhe e të gjithë qytetarëve vullnetmirë të Kosovës. Këtë vizion dhe këto synime do t’i kultivojë me përkushtim të plotë Lidhja Demokratike e Kosovës.*

### **Vlerat e lirisë dhe të pavarësisë**

Lidhja Demokratike e Kosovës i njeh si vlerë nacionale përpjekjet e shqiptarëve të Kosovës për liri e pavarësi që nga fillimi, lëvizjen nacionale të viteve '90-të, të udhëhequr nga Presidenti Historik i Kosovës, dr. Ibrahim Rugova dhe LDK-ja, si dhe luftën çlirimtare të fundit të viteve '90-të.

LDK-ja angazhohet për ruajtjen, mbrojtjen dhe kultivimin e vlerave të veprimtarisë politike nacionale dhe të luftës çlirimtare.

LDK-ja do të respektojë përherë figurat e mëdha të kombit dhe të politikës.

Duke çmuar lart sakrificën e secilit dhe duke theksuar fort rolin e vet të drejtpërdrejtë në luftën çlirimtare të Kosovës, Lidhja Demokratike e Kosovës angazhohet për mbrojtjen me ligj të të drejtave të plota të veprimtarëve nacionalë, veteranëve dhe të invalidëve të luftës, të familjeve të tyre, si dhe të familjeve të dëshmorëve.

### **Kultivimi i vlerave demokratike**

Si një parti e qendrës së djathtë, Lidhja Demokratike e Kosovës, në veprimtarinë e saj, mbështetet në vlerat demokratike, si: respekti për traditën, liria, drejtësia dhe toleranca, përgjegjësia dhe transparenca, liria e të shprehurit dhe liritë individuale dhe kolektive. Këto vlera paraqesin fundamentin e shoqërisë moderne evropiane të Kosovës.

Tri vlera themelore për të cilat punoi LDK-ja që nga formimi i saj ishin:

- a. Liria,
- b. Pavarësia dhe
- c. Demokracia.

Me Programin Nacional të miratuar në Kuvendin Themelues më 23 dhjetor të vitit 1989, LDK-ja u angazhua për daljen nga sistemi njëpartiak komunist dhe kalimin në pluralizëm politik, u angazhua për liritë e njeriut, lirinë e fjalës, lirinë e shtypit. Liri do të thotë edhe gatishmëri personale dhe kombëtare për ta fituar dhe për ta mbrojtur lirinë.

**Lirinë** LDK-ja nuk e konsideron vetëm si një të drejtë, por edhe si obligim. LDK-ja angazhohet që qytetari ta përjetojë lirinë në familje, në vendin e punës, në kohën e tij të lirë, në vendin ku jeton, në komunë dhe në shtet. Arritjet dhe prona e çdonjërit duhet të respektohen dhe të mbrohen. Jetësimi i lirisë kërkon edhe drejtësi sociale dhe mundësinë e jetesës sipas vendimeve personale. LDK-ja beson se liria e vërtetë është bashkim i personalitetit të pavarur dhe i përgjegjësisë. Liria e vërtetë e bën çdo individ të përgjegjshëm për veprimet e tij, të ndërgjegjshëm për komunitetin të cilit i takon dhe për brezat e ardhshëm. Liria, së bashku me solidaritetin dhe me përgjegjësitë për sigurimin e mirëqenies së përgjithshme, mbetet edhe sot sfidë e rëndësishme e Lidhjes Demokratike të Kosovës.

**Pavarësinë** dhe sovranitetin e vendit në tërë territorin e tij, LDK-ja e konsideron të përfunduar dhe që nuk mund të negociohet me të tjerët. Shtrirja e sovranitetit në tërë territorin e Republikës së Kosovës, veçmas në disa komuna me shumicë serbe në Veri të vendit, funksionimi i drejtë i ligjit, kontrolli i kufijve dhe përmbushja e kritereve nga marrëveshjet ndërkombëtare, janë sfida të reja për LDK-në në rrugën e forcimit të pavarësisë dhe të shtetëndërtimit. LDK-ja angazhohet për zgjidhjen me dialog të problemeve me fqinjët, pa e prekur sistemin kushtetues, rregullimin e brendshëm dhe kufijtë, duke ofruar të drejta të barabarta për të gjithë qytetarët.

**Zhvillimin demokratik të vendit** LDK-ja e vlerëson si një nga proceset shumë të rëndësishme të zhvillimit ekonomik dhe social, të forcimit të shtetit ligjor dhe të integriteteve evropiane dhe euroatlantike. LDK-ja angazhohet për funksionim të pavarur të legjislativit, ekzekutivit dhe gjyqësorit dhe për krijimin e kushteve për ngritje të efikasitetit të tyre. Pjesë e rëndësishme e angazhimit demokratik të LDK-së është ndërtimi i një sistemi zgjedhor, i cili do të mundësonte legjitimitet të plotë të përfaqësuesve të zgjedhur nga populli në nivel qendror dhe lokal dhe përgjegjësi të institucioneve të dala nga vota e popullit.

LDK-ja do të shfrytëzojë integritetin dhe dijen e saj për ta ndërtuar dhe forcuar shtetin ligjor. Perspektivën e Kosovës LDK-ja e sheh si anëtare e barabartë në familjen e shteteve të Bashkimit Evropian dhe në miqësi të përhershme me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. LDK-ja konsideron se pjesë e rëndësishme e zhvillimit demokratik të vendit është zhvillimi ekonomik, punësimi dhe krijimi i perspektivës demokratike evropiane për të rinjtë.

### **Vizioni dhe misioni për të ardhmen**

**Vizioni i LDK-së:** Lidhja Demokratike e Kosovës është parti e profilizuar, me funksionalitet të lartë, me lidhshmëri të fortë, komunikim profesional, parti me veprimtari të qartë, bindëse dhe unike në mesazhe; me njerëz të aftë dhe të shkathtë të zgjedhur në pushtetin qendror dhe lokal, me anëtarësi besnike, të përkushtuar e vullnetmirë dhe me

platformë politike, e cila ofron qasje dinamike dhe pozitive për të ardhmen evropiane të Kosovës.

**Misioni i LDK-së - Shtet për qytetarët:** Misioni i LDK-së është të ndërtojë një lidhshmëri të fortë të vendit, i cili do të ngre dhe forcojë besimin e qytetarëve të Kosovës dhe të komunitetit ndërkombëtar në vitalitetin e Kosovës si shtet i pavarur, të krijojë dhe ofrojë politika që gjenerojnë cilësi të lartë të jetës dhe respektim të të drejtave të çdo njeriu dhe të promovojë mundësi dhe qasje të barabartë për të gjithë qytetarët në arsim, shëndetësi, në jetën sociale dhe në shërbimet publike.

### **Objektivat e LDK-së: Kosova evropiane**

LDK-ja e ka objektiv ndërtimin e një Kosovë evropiane, në të cilën forcohet demokracia qytetare, sundon ligji dhe respektohen të drejtat e njeriut, promovohet mirëqenia e qytetarit dhe zhvillimi ekonomik, stimulohet tregu i hapur dhe lëvizja e lirë e qytetarëve dhe e ideve, mbështetur në arsim modern dhe në shoqëri të dijes, në të cilën respektohen vlerat dhe traditat e qytetarit të Kosovës.

LDK-ja ka dëshmuar se ka kapacitete që t'i realizojë synimet e saj. Kosova e lirë dhe e pavarur, si një synim themelor i LDK-së, sot është realitet i njohur ndërkombëtarisht. Sot, LDK-ja kërkon angazhim për ta forcuar dhe demokratizuar shtetin e Kosovës, për integrim në strukturat e Bashkimit Evropian dhe në NATO. Zhvillimi socio-ekonomik i qëndrueshëm dhe forcimi i shtetit ligjor janë parakusht për integrim të suksesshëm në këto struktura. Vetëm në këtë mënyrë Kosova, me rastin e integrit, do të ishte një vlerë e shtuar në këtë familje të madhe. Së këndejmi, promovimi i punësimit të të rinjve do të zbuste presionin emigrues dhe do të siguronte përkrahje më të madhe te vendet e BE-së për procesin e integrit.

### **Vizioni human mbi shoqërinë**

Lidhja Demokratike e Kosovës beson fuqishëm se dinjteti i çdo qenie njerëzore, si parim dhe e drejtë themelore, mund të mbrohet vetëm përmes barazisë së të gjithë qytetarëve dhe mundësive të barabarta për të gjithë, pavarësisht gjinisë, moshës, përkatësisë etnike dhe fetare. LDK-ja synon që të marrë pjesë në ndarjen e këtyre vlerave me familjen e madhe të partive popullore evropiane, si: vlera e dinjtetit personal, e lirisë dhe përgjegjësisë, e barazisë, drejtësisë, ligjshmërisë, solidaritetit dhe subsidiaritetit.

Vizioni i LDK-së për shoqërinë është vizion për:

- a) *Promovimin e dinjtetit të çdo qenie humane për:*
  - Kreativitet të lirë të qytetarëve në të gjithë sektorët dhe jetën sociale;
  - Rolin e familjes, edukimit dhe jetën në komunitet;
  - Mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të grupeve minoritare, solidaritetin me grupet e cenueshme dhe të moshuarit;
  - Respektin për jetën në të gjitha format dhe moshat;

- Respektimin e dinjitetit human në mjekësi dhe rregullave etike gjatë aplikimit të rezultateve shkencore.

-

*b) Mbështetjen e familjes, të rinjve dhe femrave*

Familja luan rol kyç në ndërtimin e një shoqërie demokratike, prandaj LDK-ja angazhohet për fuqizimin e këtij institucioni, sepse, si parti e qendrës së djathtë, beson se ajo që është e mirë për familjen dhe të rinjtë, është e mirë edhe për shoqërinë. Brenda familjes mësohen virtetet sociale, obligimet reciproke, besimi dhe përgjegjësia. Vlerat familjare janë themelore për zhvillimin e individit, por edhe për unitetin social. LDK-ja angazhohet për barazi të plotë gjinore.

LDK-ja është e bindur se rinia është pasuria më e madhe e Kosovës, rinia është burimi kryesor i zhvillimit ekonomik dhe potenciali kryesor për ndërtimin e shtetit demokratik e të qëndrueshëm.

Për më tepër, LDK-ja angazhohet për mbrojtjen efektive të të drejtave të fëmijëve, duke krijuar kushte të përshtatshme që ata të mund ta shpalosin personalitetin e tyre dhe të ushtrojnë virtetet e mësuara, të kenë institucione, të cilat do të funksionojnë në mënyrë të përshtatshme, duke i përgatitur në rrugën e edukimit dhe arsimimit në një ambient të sigurt.

LDK-ja e synon një Kosovë të njerëzve të lirë dhe të përgjegjshëm, të aftë që të ndërtojnë të ardhmen, të zgjedhin punën, të vendosin për ngritjen e familjes dhe rritjen e fëmijëve të tyre, bazuar në idetë dhe vlerat e tyre. Ne synojmë një shoqëri në të cilën të gjithë njerëzit e rinj, kanë mundësi të shkollohen dhe të marrin diploma cilësore. Ne dëshirojmë një shoqëri në të cilën njerëzit e rinj kanë punë, që atyre ua mundëson që të jenë të pavarur dhe të ngrisin familjet e tyre. Ne dëshirojmë një shoqëri në të cilën asnjëri nuk mbetet prapa, sepse çdo njeri ka vlera të paçmueshme dhe sepse mirëqenia e çdo qytetari është mirëqenie e të gjithë qytetarëve dhe mirëqenie e shoqërisë në përgjithësi.

LDK-ja beson veçanërisht në veprimin afirmativ, i cili siguron barazi efektive ndërmjet meshkujve dhe femrave, për të siguruar qasje të gruas në arsim, në punë dhe në pozitat dhe përgjegjësitë më të larta në jetën publike dhe në sektorin privat. Barazia më e madhe efektive ndërmjet meshkujve dhe femrave, e bën vendin tonë edhe më të drejtë, por edhe më perspektiv.

*c) Ekonominë e tregut*

Historia dhe përvoja kanë treguar se iniciativa private, ndërmarrësia e lirë, konkurrenca, disiplina e tregut, tregu i hapur dhe i lirë janë forca shtytëse të progresit ekonomik. Në të njëjtën kohë, autonomia e odave tregtare dhe e organizatave të punëtorëve, negociimi i lirë ndërmjet tyre për kushtet e punës, pagesat dhe involvimi dhe përgjegjësia e tyre në menaxhimin e sistemit të mbrojtjes sociale janë garantues për zhvillimin social, ndërkaq autoritetet publike do të ndërtojnë rregullat që nxisin zhvillim ekonomik dhe mirëqenie sociale. Do të ndërtojmë një ekonomi sociale dhe ekologjike të tregut, në të cilën qeveria përcakton kornizat që rregullojnë aktivitetet ekonomike. Ekonomia sociale e tregut definon vlerat e këtyre aktivitetëve, të cilat respektojnë dinjitetin human. Ne



kemi përgjegjësinë dhe besojmë se brezave të ardhshëm duhet t'ua sigurojmë kushtet që të jetojnë në harmoni me ambientin natyror.

LDK-ja i ofron Kosovës shoqëri të lirë, zhvillim ekonomik dhe solidaritet. Qeverisja e LDK-së do të jetë qeverisje e drejtë dhe demokratike për të gjithë kosovarët. Ne e ndërtojmë këtë moral politik.

## **II. REFORMAT DHE MODERNIZIMI I PARTISË**

Ne besojmë se koha në të cilën jetojmë kërkon ndryshime. Nëse ne nuk bëjmë ndryshime të shpejta, realiteti mund t'i ndryshojë gjërat jashtë dëshirës sonë.

Në rrugën e realizimit të synimeve dhe të objektivave, LDK-ja do ta ruajë fundamentin rugovian të saj dhe vlerat bazike e, krahas kësaj, me programin, organizimin dhe anëtarësinë e saj, do të profilizohet qartas, në një konkurrencë shumëpartiake në Kosovë, në frymën e kërkesave të reja për ndërtimin dhe funksionalizimin e shtetit të Kosovës dhe përfaqimin e vlerave evropiane. Ajo do të bashkëpunojë ngushtë me partitë popullore evropiane dhe do të bëhet anëtare e kësaj familjeje.

Synim themelor i LDK-së është hapja ndaj të rinjve, femrave dhe të gjithë atyre që ardhmërinë e Kosovës e shohin në qeverisje të drejtë, ligjore, demokratike dhe evropiane. LDK-ja kërkon nga gjithë degët e saj, që së bashku me Forumi e Rinisë së LDK-së, të krijojnë mekanizma për përfshirje më të madhe të të rinjve në radhët e saj, që nga shkolla e mesme, fakulteti, të atyre të punësuar dhe të papunësuar. LDK-ja, po ashtu, e sheh të domosdoshme përfshirjen më të madhe të gruas në të gjitha aktivitetet dhe në të gjitha forumet e saj dhe një rol më të madh të gruas në ndërtimin e shoqërisë sonë.

Deri në zgjedhjet e ardhshme të brendshme, Këshilli i Përgjithshëm, Kryesia e LDK-së, kryesitë e degëve dhe nëndegëve do të zgjerohen me përfshirje të re të të rinjve dhe grave për 20 për qind. Përfshirja e të rinjve dhe grave dhe zgjerimi me anëtarësi të re është faktor i rëndësishëm për të identifikuar kërkesat e anëtarësisë së gjerë, për t'u ballafaquar me sfidat e ardhshme dhe për të krijuar hapësirë për hapje edhe më të madhe në zgjedhjet e ardhshme partiake. Politikat e LDK-së për përfshirje më të madhe të të rinjve në radhët e veta do të shkojnë krahas uljes së moshës së të rinjve në Forumin e Rinisë nga 30 në 26-vjeç.

Të gjitha organet e LDK-së në nivel qendror, degë dhe nëndegë do të punojnë për identifikimin dhe tërheqjen e ekspertëve nga të gjitha fushat në aktivitetet e veta, do të krijojnë ura të bashkëpunimit me institucionet arsimore, shkencore, kulturore, sportive, me bizneset dhe akterë të tjerë të jetës sociale dhe ekonomike.

Strukturimi dhe fuqizimi i organeve dhe forumeve të LDK-së do të zhvillohet përmes krijimit të një kohezioni dhe bashkëjetese të brendshme ndërmjet gjithë veprimtarëve të LDK-së, të cilët që nga themelimi apo për një kohë të gjatë kanë qenë shtyllë e LDK-së dhe të gjithë atyre që ardhmërinë dhe perspektivën e tyre dhe të vendit e shohin te Programi dhe politikat e Lidhjes Demokratike të Kosovës. Kriteri i vlerës së LDK-së do të jetë vlera shtuese e saj, nga idetë, angazhimi në terren, ekspertiza, përkushtimi ditor

dhe vota e arritur si individë, si organe dhe anëtarësi në nivel të nëndegëve, degëve dhe në nivel qendror, në zgjedhjet lokale dhe ato nacionale.

LDK-ja do ta thjeshtëzojë organizimin e saj në terren, duke u organizuar në nivel të degëve dhe të nëndegëve, për të krijuar kushte për komunikim të drejtpërdrejtë me çdo anëtar të LDK-së. Degët jashtë vendit tonë do të luajnë një rol të veçantë në procesin e integritimit, në bashkëpunimin dhe këmbimin kulturor, në arsimimin e të rinjëve dhe ruajtjen e gjuhës shqipe dhe në tërheqjen e investimeve në Kosovë.

LDK-ja do të funksionalizojë Fondacionin “Ibrahim Rugova”, i cili do të luajë rol të rëndësishëm në hulumtimet humanitare, sociale e politike, në hulumtimin e opinionit publik, në përkrahjen e veprimtarëve dhe krijuesve të rinj, si dhe në trajnimet dhe përgatitjen e stafit politik të LDK-së.

LDK-ja e sheh si shumë të rëndësishëm komunikimin me anëtarësinë dhe komunikimin me opinionin. Do të vazhdohet me agjendën e takimeve të drejtpërdrejta me kryetarë të degëve në nivel qendror dhe të nëndegëve në nivel të degëve dhe do të avancohet komunikimi përmes Web-faqes së LDK-së. Ne angazhohemi që komunikimi të shprehë unitetin e partisë, të jetë i bashkërenditur, në mënyrë që mesazhet që jepen për anëtarësinë dhe opinionin, të jenë mesazhe që shprehin politikën dhe programin e LDK-së.

LDK-ja do të punojë për ndërtimin e sistemit të komunikimit strategjik brenda partisë dhe me opinionin publik, të përparojë sistemin e komunikimit të bashkërenduar ndërmjet Kryesisë së LDK-së, Grupit Parlamentar të LDK-së dhe Këshillit të Ekspertëve, për të krijuar një efikasitet më të lartë të punës së Parlamentit të Republikës së Kosovës. Po ashtu, do të krijohen rrugë të komunikimit edhe me subjektet e tjera politike për çështjet të cilat konsiderohen se janë me rëndësi për zhvillimin demokratik të vendit dhe për përmbushjen e agjendës evropiane.

Ideja e LDK-së ishte dhe mbeti ide e paqes, e lirisë, ide e vullnetit dhe e përkushtimit për të ndërtuar një shtet të drejtë, një shtet prosperues evropian. Janë këto ide me vlera të përhershme, janë këto vlerat që njerëzit e LDK-së i mbajnë së bashku.

LDK-ja e kultivon kohezionin e saj të brendshëm dhe siguron pjesëmarrje të gjerë të të gjithë anëtarësisë në vendimmarrje si asnjë forcë politike në vend. Vetëm partitë që kanë organizim demokratik mund të qeverisin në mënyrë demokratike.

Ne kërkojmë përkrahjen e të gjithë kosovarëve, të gjithë grave dhe meshkujve që e dojnë lirinë dhe që dëshirojnë të jetojnë të lirë, ne kërkojmë votën e tyre për të siguruar këto vlera dhe për të sendërtuar programin tonë.

### **III. QEVERISJE NË SHËRBIM TË QYTETARËVE**

Në këtë fazë të tranzicionit, Republika e Kosovës po ballafaqohet me shumë sfida dhe probleme, si: papunësia strukturore, ngecja në zhvillimin ekonomik, sidomos në prodhimtarinë vendore, mungesa e energjisë elektrike dhe ujit, mungesa e masave dhe instrumenteve për tërheqjen e investimeve të huaja direkte, paqëndrueshmëria në

konkurrencën ndërmjet sektorit publik dhe atij privat, qëndrueshmëria e ulët buxhetore, varfëria e lartë, korrupsioni i lartë dhe krimi i organizuar, qeverisja e dobët korporative e kompanive publike, cilësia e ulët dhe jokonkurrese e arsimit. Andaj, LDK-ja konsideron se zgjidhja e këtyre problemeve është parakusht për stabilitetin e brendshëm ekonomik dhe social dhe për të qenë anëtar i barabartë dhe i respektuar i familjes evropiane. LDK-ja ka integritet dhe dije për t'i zgjidhur problemet e tilla.

Shteti i Kosovës duhet të forcohet për qytetarët e tij, t'i mbështesë ata në përpjekjet e tyre për të siguruar të ardhura, të sigurojë që asnjë qytetar të mos mbetet pa qasje në arsim, shëndetësi, përkujdesje sociale dhe shërbime të tjera publike. Ofrimi i arsimit dhe shëndetësisë cilësore për të gjithë qytetarët mbetet sfidë e vazhdueshme.

Kosova ka nevojë ta zërë hapin me zhvillimet evropiane në fushën e përkrahjes institucionale për biznese dhe të infrastrukturës komplekse ekonomike dhe sociale. Biznesi në Kosovë po ngec prapa konkurrencës që vjen nga tregjet evropiane dhe globale, për mungesë të rritjes së mjaftueshme të produktivitetit dhe përkrahjes institucionale gjithëpërfshirëse. Kosova, e pasur me burime energjetike dhe minerare, po përballet me mungesë elementare të energjisë elektrike dhe ende nuk e ka zënë vendin e duhur në tregjet ndërkombëtare të mineraleve. Toka e plleshme e Kosovës nuk po shfrytëzohet në mënyrë produktive, pasi shumë bujq të devotshëm e gjejnë të pamundur të ofrojnë produkte në treg në mungesë të përkrahjes institucionale. Si rrjedhim, tregu vendor është i mbushur me produkte nga importi nga vende ndaj të cilave Kosova në shumë aspekte ka përparësi në tregtinë ndërkombëtare.

Pas shumë viteve të një buxheti të balancuar dhe suficitar, vendi po zhytet në deficite të vazhdueshme. Kjo po e rrezikon qëndrueshmërinë buxhetore të Republikës së Kosovës në një kohë krize në gjithë eurozonën. Rreziku qëndron në ngarkesën e barrës fiskale, që mund t'ju bëhet brezave të ardhshëm, që vjen nga huazimi momental për të mbuluar deficitet buxhetore. Varfëria dhe papunësia në vend mbetet në nivele të larta, duke iu pamundësuar shumë familjeve dhe fëmijëve të tyre një zhvillim normal afatgjatë. Skema e mbështetjes sociale është e pazhvilluar, e pamjaftueshme, sikurse edhe skema pensionale. Shpenzime kapitale publike nuk po sigurojnë rritje të qëndrueshme afatgjate të ekonomisë, efekte multiplikuese në ekonomi dhe përfitim të barabartë për të gjithë qytetarët.

Sigurimi i njohjeve nga vendet e mbetura të BE-së dhe arritja e numrit të nevojshëm të njohjeve për integrim në organizmat ndërkombëtarë mbetet sfidë për Kosovën edhe për një kohë. Forcimi i shtetit ligjor dhe sigurimi i kohezionit të brendshëm socio-ekonomik, do të ndihmojë shumë konsolidimin e shtetësisë së Kosovës në arenën ndërkombëtare.

LDK-ja do të përkrahë bizneset, sepse ato krijojnë vende të reja pune; LDK-ja do të përkrahë bujqësinë, sepse ajo ofron mundësi për ushqim më të shëndetshëm vendor; LDK-ja do të përkrahë ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, sepse ato ofrojnë shanse për punësim dhe prodhimtari vendore; LDK-ja do të përkrahë garën me të tjerët, sepse ajo forcon cilësinë; LDK-ja do të përkrahë arsimin cilësor, sepse kemi rini të shëndoshë; LDK-ja do të përkrahë stabilizimin buxhetor dhe financiar të vendit.

Ne dëshirojmë ekonomi të fortë e të qëndrueshme dhe biznese të shëndetshme të bazuara në aktivitete moderne dhe efçente, kreativitet dhe inovacione, sepse pa rritje ekonomike nuk do të ketë zgjidhje të problemeve sociale dhe ofrim të shërbimeve që i kërkojnë qytetarët.

Ne besojmë thellë se politika duhet të jetë në shërbim të qytetarëve e jo qytetarët në shërbim të politikës dhe se ajo duhet të jetë shumë më e bazuar në vlera e jo në interesa të ngushta.

#### **IV. SHTETI LIGJOR**

LDK-ja është e vendosur për luftimin e pakompromis të kriminalitetit, korrupsionit, krimit të organizuar, krimit ekonomik, trafikimit të qenieve njerëzore dhe formave dhe llojeve të tjera të kriminalitetit. Kjo luftë mund të realizohet vetëm me njerëz që kanë duar të pastra dhe që janë të përgjegjshëm.

LDK-ja është e përkushtuar për mbrojtjen efektive të të drejtave dhe lirive themelore të qytetarëve të Kosovës, të mishëruara në Kushtetutë dhe në konventa e akte të tjera ndërkombëtare, që janë drejtpërdrejt të aplikueshme në Kosovë. Barazia e qytetarëve para ligjit, gjykimi i drejtë, mosdiskriminimi, e drejta pronësore, liria e siguria, dinjiteti i njeriut dhe të drejtat e tjera qytetare janë themelet e rendit kushtetues e ligjor në Kosovë, prandaj LDK-ja angazhohet fuqishëm për mbrojtjen e këtyre parimeve dhe të drejtave.

LDK-ja synon që sistemi i drejtësisë dhe i sigurisë që në Kosovë të jetë funksional, profesional, i depolitizuar, i integruar dhe i shtrirë në tërë territorin e vendit, në përputhje me standardet evropiane në fushën e ligjit dhe të sigurisë. Sistemi i drejtësisë dhe të sigurisë duhet të jenë në shërbim të të gjithë qytetarëve. LDK-ja e vlerëson si shumë të rëndësishme punën e organeve që merren me sundimin e ligjit dhe sigurisë së brendshme dhe të jashtme dhe angazhohet për fuqizimin e tyre në përputhje me parimin e ndarjes së pushteteve.

LDK-ja angazhohet për reformimin e vazhdueshëm të sistemit gjyqësor drejt një sistemi të pavarur, efikas dhe kredibil, që është garant i sundimit të ligjit dhe i mbrojtjes i së të drejtave dhe të lirive qytetare, të garantuara me ligjin vendor dhe ndërkombëtar. LDK-ja angazhohet për ngritjen dhe profesionalizimin e gjyqtarëve dhe garantimin e mirëqenies dhe të sigurisë së tyre. LDK-ja parasheh një sistem alternativ të zgjidhjeve të kontesteve, që përfshin arbitrazhin dhe ndërmjetësimin, që do të lehtësonte barrën e gjyqësisë, do të zvogëlonte koston e zgjidhjes së kontesteve, do të shpejtonte zgjidhjen e kontesteve, do të promovonte investimet e jashtme në vend dhe do të stimulonte ekonominë.

LDK-ja angazhohet për reformimin e vazhdueshëm të organit të akuzës dhe fuqizimin e saj, si parakusht për luftimin efikas dhe efektiv të kriminalitetit. LDK-ja është e përkushtuar për një prokurori të pavarur dhe të paanshme, me qëllim që, pa kompromis, t'i luftojë të gjitha format e kriminalitetit, duke mbrojtur vlerat më vitale të qytetarit dhe të shoqërisë. LDK-ja është e angazhuar për mbështetjen e profesionit të pavarur të avokatit.

LDK-ja angazhohet që forcat e sigurisë dhe të policisë të kenë ngritje të vazhdueshme profesionale dhe modernizim me pajisje konform standardeve të NATO-s dhe mekanizmave të tjerë ndërkombëtarë përkatës. LDK-ja angazhohet për ruajtjen e interesit publik dhe sigurisë kombëtar përmes mbështetjes të një inteligjence të profesionale dhe të depolitizuar. Për shkak të ndjeshmërisë së sferës së sigurisë, LDK-ja angazhohet për rregullimin dhe kontrollimin demokratik të sistemit të sigurisë, duke e harmonizuar atë me konventat ndërkombëtare nga kjo fushë.

Prandaj, LDK-ja angazhohet që, përmes luftimit të fenomeneve negative dhe krijimit të ambientit të përshtatshëm dhe të sigurt për investime, të rrisë numrin e investimeve të jashtme në Kosovë.

## **V. ZHVILLIMI EKONOMIK**

### **Filozofia e LDK-së për zhvillim ekonomik**

LDK-ja beson se iniciativa private, konkurrenca dhe tregu i hapur janë forcat kryesore që sigurojnë prosperitet ekonomik. Në këtë aspekt, roli i Parlamentit dhe i Qeverisë është të ofrojnë një kornizë ligjore brenda së cilës zhvillohen këto aktivitete. E drejta për ndërmarrësi të lirë dhe për të realizuar fitim gjithashtu involvon edhe obligimin apo solidaritetin ndaj të gjithë atyre që përfshihen direkt ose indirekt në atë aktivitet ndërmarrës. Përmes interaksionit të ndërmarrësve me shtetin, institucionet financiare, arsimore dhe trajnuese dhe politikave sociale, mundësohet kohezioni i brendshëm i ekonomisë dhe i shoqërisë.

Bazuar në këtë filozofi, LDK-ja angazhohet fuqishëm për forcimin e ekonomisë së tregut në Kosovë, për promovimin e konkurrencës dhe integrimin në tregje rajonale dhe globale. Fryma e ndërmarrësisë, që është pjesë e filozofisë dhe e mbijetesës së popullit të Kosovës ndër vite, duhet të promovohet në të gjitha politikat. Popullsia e re e Kosovës është aseti më me vlerë që ka Kosova. Mbi këtë bazë, politikat zhvillimore duhet të jenë në funksionin të ngritjes së vazhdueshme të cilësisë së arsimit. Në përputhje me standardet evropiane, duhet të përmirësohet ambienti për gjenerimin e ideve ndërmarrëse, për tërheqjen e investimeve të jashtme dhe për promovimin e punësimit. Megjithatë, zhvillimi ekonomik është i qëndrueshëm, nëse resurset shfrytëzohen racionalisht dhe të gjithë përfitojnë nga zhvillimi.

Politikat ekonomike të LDK-së do të krijojnë kushte për përmirësim të cilësisë së jetës të të gjithë qytetarëve. Zhdukja e varfërisë do të zë vend qendror në politikat e qeverisjes së LDK-së. Të gjithë qytetarët e Kosovës duhet të përfitojnë nga sistemi gjithëpërfshirës i shëndetësisë dhe i politikave sociale. Ofrimi i shërbime publike cilësore dhe ndërtimi i institucione transparente mbeten çështje parimore në qeverisjen e LDK-së.

Sfida kryesore për qeverisjen e ardhshme mbetet transformimi i ekonomisë së Kosovës nga një ekonomi e bazuar në import, në një ekonomi të bazuar në prodhim vendor, promovim të eksportit dhe të dijes. Në këtë drejtim, sfidë mbetet fuqizimi i konkurrencës, rritja e produktivitetit të ndërmarrësve vendorë dhe involvimi aktiv në

tregjet ndërkombëtare. Eliminimi i barrierave për biznes dhe ndërmarrësi private është çelësi për këtë transformim të ekonomisë së Kosovës.

Politikat ekonomike të LDK-së synojnë krijimin e kushteve të barabarta për investime, përmes infrastrukturës rrugore, të telekomunikimit, energjisë dhe ujit, në mënyrë që të krijohen kushtet për një zhvillim harmonik dhe që të tejkalohen diferencat rajonale në tregun e punës.

LDK-ja konsideron se zhvillimi ekonomik u takon të gjithë qytetarëve të Kosovës, brenda dhe jashtë saj, prandaj do të sigurojë një përfshirje aktive në zhvillimin ekonomik të vendit të bashkatdhetarëve tanë, që punojnë dhe jetojnë në shtetet e tjera.

### **Zhvillimi i sektorit privat**

Një sektor privat dinamik, ua mundëson të rinjve që të krijojnë vetë vendet e tyre të punës. Avancimi i ekonomisë së dijes dhe fuqizimi i aftësive konkurruese vendore është parakusht i rëndësishëm. Stimulimi i prodhimit vendor dhe përmirësimi i kualitetit të produkteve dhe shërbimeve vendore është hapi i parë drejt zvogëlimit të varësisë nga importet. Tregu dhe konkurrenca globale fitohet fillimisht duke u konkurruar në tregun lokal produkteve të importuara.

Investimet e huaja luajnë rol kyç në rritjen e potencialeve prodhuese të ekonomisë kosovare. LDK-ja beson se rritja e kapacitete prodhuese, krijimi i vendeve të punës, përmirësimi i bilancit tregtar, si dhe përmirësimi i cilësisë së produkteve dhe i shërbimeve arrihet më shpejt përmes politikave që e bëjnë Kosovën venddestinim për investitorë të jashtëm. LDK-ja angazhohet për fuqizimin e kornizës ligjore, që i mbron investitorët e jashtëm, njësoj sikurse investitorët vendorë.

Një ambient financiar i sigurt dhe i qëndrueshëm mundëson realizimin e ideve ndërmarrëse përmes ofrimit të kushteve të volitshme kreditore. LDK-ja angazhohet për rritje të konkurrencës në sektorin financiar dhe rritje të efikasitetit të funksionimit të sistemit të drejtësisë dhe të mbrojtjes së investitorëve, e bindur se këto masa do të mundësojnë që kushtet e kreditimit të ndërmarrësve të jenë më të volitshme. Mobilizimi i fondeve të privatizimit dhe fondit pensional krijon potenciale zhvillimore, por duhet të jetë i paraprirë me një strategji nacionale për shfrytëzimin dhe garantimin e atyre fondeve.

### **Përmirësimi i kornizës ligjore dhe zvogëlimi i burokracisë në raport me bizneset**

LDK-ja angazhohet për eliminimin e barrierave ligjore, që e pengojnë zhvillimin e hovshëm të biznesit, duke promovuar lirinë e lëvizjes së njerëzve, mallrave, kapitalit dhe shërbimeve. Korniza ligjore duhet të vlerësohet në baza të rregullta për efektet e saj dhe të ndryshojë në përputhje me zhvillimet në treg. LDK-ja do të insistojë për një rol të shtuar të autoriteteve lokale në ofrimin e lehtësirave të të bërit biznes, duke mundësuar kornizë ligjore të decentralizuar dhe diskrecion të nevojshëm të autoriteteve lokale, për të nxitur garën e tyre për tërheqje të bizneseve në lokalitetet e tyre.

## **Mbështetja e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme**

Rreth 99 për qind të ndërmarrjeve në Kosovë janë ndërmarrje të vogla dhe të mesme (NVM), të cilat punësojnë mbi 80 për qind të të punësuarve në sektorin privat. Aftësia e këtyre ndërmarrjeve për të operuar dhe t'iu përshtatur kushteve të tregut siguron të ardhura për numrin e madh të të punësuarve në këto ndërmarrje. LDK-ja angazhohet që themelimi dhe funksionimi i NVM-ve të jetë shumë më i lehtë nga ana burokratike.

## **Investimi në kapitalin njerëzor dhe nxitja e inovacioneve**

Numri i madh i të rinjve që ka Kosova është parakusht për një ekonomi me fuqi punëtore dinamike. Por, ky resurs mund të vihet në funksion vetëm përmes ofrimit të arsimit cilësor, fleksibël ndaj kërkesave të tregut dhe të diversifikueshëm. Në këtë drejtim, LDK-ja angazhohet për një treg të institucioneve arsimore, me mundësi për arsimin publik dhe privat, i cili reflekton ndaj nevojave të tregut për aftësi konkurruese dhe për aplikimin e standardeve evropiane. Një sistem i tillë arsimor mundëson krijimin e njerëzve inovativë dhe me aftësi kompatible për t'iu përshtatur ndryshimeve të shpejta dhe të vazhdueshme të nevojave të tregut. Duhet të investohet në inkubatorët e biznesit dhe duhet të mbështeten sidomos idetë dhe bashkëpunimi në biznes në mes të diasporës dhe bizneseve kosovare.

## **Bujqësia, zhvillimi rural dhe turizmi**

Bujqësia mbetet sektor shumë i rëndësishëm për promovimin e punësimit në Kosovë, për rritjen e të ardhurave të shumë familjeve në zonat rurale dhe zvogëlimin e varfërisë. Për më tepër, varësia e madhe e konsumit të mallrave ushqimore nga importi dhe deficitin e thellë tregtar i Kosovës, mund të përmirësohen vetëm përmes rritjes së prodhimit vendor në bujqësi. LDK-ja angazhohet fuqishëm për promovimin e zinxhirit prodhues, nga prodhimi primar bujqësor, tek procesimi, ruajtja dhe tregtimi me produkte bujqësore, si dhe masa nxitëse kreditore dhe subvencionuese dhe përmirësimin e infrastrukturës publike. Mbulimi i tregut vendor me produkte bujqësore nga vendi, është hapi i parë i mbështetjes në prodhimtarinë vendore.

LDK-ja e konsideron shumë të rëndësishëm shfrytëzimin e begatave turistike, me qëllim që të nxitet zhvillimi i qëndrueshëm dhe harmonik i turizmit nëpërmjet afirmimit dhe ruajtjes së vlerave, si: tradita e vendit, kultura, folklori, thesari arkeologjik, qytetet muze dhe monumentet historike. Përparësi do t'u jepet programeve dhe objekteve të turizmit, të cilat ofrojnë mundësi të turizmit të lidhur me vendet fqinjë.

## **Mbështetja e biznesit për të zvogëluar kostot**

Burokracia e madhe shkatërron konkurrencën dhe rrit koston e punës. LDK-ja angazhohet për zvogëlimin e tarifave administrative dhe implementimin e katër lirive bazike, liria e lëvizjes së njerëzve, mallrave, kapitalit dhe shërbimeve. Po ashtu, LDK-ja konsideron se mënyra më efektive që bizneset vendore të zotërojnë tregun vendor dhe të depërtojnë në tregje ndërkombëtare është përmes rritjes së produktivitetit dhe zvogëlimin të kostove. Investimet intensive në infrastrukturë, përfshirë edhe atë hekurudhore, ndërtimi i kapaciteteve stabile të termocentraleve dhe lidhjet me rrjetet

energjetike të vendeve fqinjë, promovimi i alternativave të reja për furnizim me energji dhe gaz natyror ndihmojnë drejtpërdrejt në uljen e kostove dhe në rritjen e konkurrencës.

### **Politikat tatimore**

LDK-ja do të angazhohet që politikat fiskale të zhvillohen në harmoni me kriteret të cilat derivojnë objektivat ekonomike, duke stimuluar investimet e reja, punësimin dhe tërheqjen e kapitalit të jashtëm.

LDK-ja vlerëson se tatimet e larta dekurajojnë investimet produktive dhe dëmtojnë punësimin. Tatimet duhet të jenë aq sa nevojitet për të mbuluar funksionet thelbësore të shtetit, duke i lënë qytetarët dhe bizneset të vendosin vetë për formën e investimit të të ardhurave të tyre. Aplikimi i një sistemi të thjeshtë tatimor mbetet prioritet i LDK-së, duke respektuar parimet e drejtësisë dhe trajtimit të barabartë të tatimpaguesve nëpërmjet shpërndarjes së barrës tatimore proporcionalisht. LDK-ja beson se ka mjaft hapësirë në Kosovë për rritje të të hyrave buxhetore përmes luftimit të informalitetin dhe evazionit fiskal.

### **Shpenzimet publike**

LDK-ja angazhohet për një qeveri dhe sektor publik të vogël dhe efikas, me dikastere qeveritare që janë funksionale dhe të madhësisë optimale, në përputhje me nevojat për shërbime ndaj qytetarëve dhe bizneseve. LDK-ja beson në politika buxhetore që ruajnë qëndrueshmërinë e buxhetit shtetëror.

LDK-ja angazhohet për një disiplinë financiare sa i përket buxhetit të shtetit, për të siguruar që brezat e ardhshëm të mos e bartin barrën e shpenzimeve që ndodhin tani. Kjo qasje siguron drejtësi në shpërndarjen e barrës fiskale.

LDK-ja angazhohet për transparencë të plotë në shpenzimin e parasë publike, duke ua kthyer paranë atyre që tatimohen përmes shërbimeve publike cilësore në arsim, shëndetësi, infrastrukturë dhe në funksionimin eficient të pushtetit qendror dhe lokal. LDK-ja do të sigurojë që shpenzimet kapitale të prodhojnë efekte maksimale për ekonominë vendore dhe përfitime të barabarta për të gjithë qytetarët.

### **Ndërmarrjet publike**

LDK-ja angazhohet për një qeverisje korporative të përgjegjshme dhe profesionale, që siguron qëndrueshmëri të ndërmarrjeve publike, cilësi të lartë të shërbimeve ndaj qytetarëve dhe ekonomi të shkallës që ofron shërbime me kosto më të ulët se sa sektori privat. Kontrolli dhe monitorimi i vazhdueshëm, auditimet dhe aplikimi periodik i mekanizmave për vlerësimin e performancës të ndërmarrjeve publike do të promovohen.

### **Anëtarësimi në organizatat ekonomike ndërkombëtare**

LDK-ja angazhohet për anëtarësim në organizata ndërkombëtare mbi baza të interesave ekonomike dhe shtetërore. Prioritet do të jetë anëtarësimi në BERZH, OBT dhe



organizata të tjera ekonomike ndërkombëtare. Me rëndësi të veçantë është respektimi i obligimeve që dalin nga anëtarësimi në këto organizata, duke siguruar që tregu kosovar të mbetet i hapur. Anëtarësimi në këto organizata, mundëson që ekonomia kosovare të përfitojë më shumë nga globalizimi i tregjeve, por gjithmonë duke promovuar interesat dhe vlerat e saj bazuar në reciprocitet dhe përfitime të dyanshme për veten dhe partnerët e saj strategjikë. Në këtë drejtim, LDK-ja angazhohet për një sistem të tregtisë ndërkombëtare, që siguron shpërndarje të barabartë të përfitimeve dhe të rritjes ekonomike.

### **Energjetika, minierat dhe ruajtja e ambientit**

LDK-ja është e vetëdijshme për rëndësinë e energjisë për zhvillimin ekonomik. Megjithatë, LDK-ja angazhohet për një shfrytëzim optimal të burimeve energjetike që ka Kosova, si një e mirë publike edhe për brezat e ardhshëm, duke përmbushur kriteret evropiane ambientaliste. Sigurimi i kapaciteteve për gjenerimin e energjisë elektrike, do të varet edhe nga shfrytëzimi i burimeve të tjera që ofron natyra. Përdorimi i ujit, diellit, erës dhe burimeve të tjera të përtëritshme për prodhim të energjisë, duhet të mbështeten për ta zbutur sa më shumë kërkesën për energji nga burime të paripërtëritshme, si dhe për të siguruar një ambient të pastër.

Në sektorin e minierave, LDK-ja angazhohet për qasje strategjike të shfrytëzimit të pasurive minerale. Vendimet për të ardhmen e minierës së Trepçës dhe minierave të tjera të rëndësisë strategjike, do të bazohen në strategji të qartë që reflektojnë interesat ekonomike dhe shtetërore të Kosovës. LDK-ja konsideron se vendimmarrja për të ardhmen e pasurive natyrore të Kosovës, shfrytëzimin dhe menaxhimin e tyre duhet të jetë përgjegjësi e Parlamentit të Republikës së Kosovës.

Ruajtja e ambientit është një obligim dhe zotim për mirëqenien e brezave të ardhshëm. LDK-ja angazhohet për strategji që përcakton vlerat kufitare për lirim të gazrave, kriteret për mbrojtjen e ujërave, ajrit dhe të tokës nga ndotja dhe përdorimi i teknologjisë që mbron klimën. Kursimi i energjisë, ngritja e efikasitetit të energjisë dhe shfrytëzimi i energjisë riprodhuese do të jenë shtylla bartëse të politikës sonë për mbrojtje të ambientit dhe të klimës. LDK-ja do të angazhohet edhe për strategjitë të përshtatshme të shfrytëzimit të tokave nën kushte të ndryshueshme klimatike. Ruajtja e pasurive pyjore dhe investimet në gjelbërimin e zonave, do të jetë me prioritet të veçantë.

### **Sistem financiar i qëndrueshëm dhe në funksion të zhvillimit ekonomik**

LDK-ja angazhohet për një sistem financiar konkurrent dhe që krijon kushte të përshtatshme për stimulim të biznesit privat, ndërmarrësisë dhe ideve inovative biznesore. LDK-ja angazhohet për mobilizim të plotë të kursimeve financiare nga fondi i privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore, nga kursimet e trustit pensional, kursimet e diasporës dhe kursimeve të tjera të qytetarëve dhe bizneseve. Këto fonde mund të vihen në funksion vetëm përmes një sistemi të integruar dhe funksional ligjor dhe financiar që mbron të drejtat e pronarëve dhe që siguron pacenueshmërinë e interesave, pronës dhe të drejtave investitorëve dhe depozitorëve. LDK-ja angazhohet për një rol mbikëqyrës

dhe të pavarur të Bankës Qëndrore të Kosovës, si dhe angazhohet që Banka Qendrore e Kosovës të bëhet pjesë përbërëse dhe anëtare e barabartë e Bankës Qendrore Evropiane.

## **VI. ARSIMI DHE SHKENCA**

Vizioni i LDK-së është që Kosova të zhvillohet drejt një shoqërie të dijes, të integruar në rrjedhat evropiane të arsimit dhe të shkencës. Një shoqëri e tillë ndërtohet përmes mundësive të barabarta për arsim dhe zhvillim personal për të gjithë qytetarët.

LDK-ja angazhohet për një sistem arsimor gjithëpërfshirës, që siguron kushte për formim cilësor dhe në përputhje me nevojat e tregut të punës dhe të shoqërisë.

LDK-ja e konsideron arsimin si një ndër përcaktuesit kryesorë të progresit dhe të qëndrueshmërisë afatgjatë ekonomike dhe sociale të vendit.

LDK-ja angazhohet për integrimin e arsimit të Kosovës në Hapësinë Evropiane të Arsimit.

LDK-ja do të ofrojë mundësi që të rinjtë të bëjnë zgjedhjen për arsim të përgjithshëm ose profesional, në përputhje me objektivat dhe interesin e tyre dhe tregun e punës.

Promovimi i shkathtësive për ndërmarrësi në planprogramet arsimore, në të gjitha nivelet dhe në profilet arsimore, LDK-ja i konsideron themelore për gjenerimin e ideve të reja dhe për punësimin e të rinjve që mbarojnë shkollimin. Për këtë arsye do të promovohet të mësuarit gjatë gjithë jetës, për të mundësuar përtëritjen e diturive dhe të njohurive, në përputhje me rrjedhat e zhvillimit të sektorëve të ekonomisë.

LDK-ja do të përkrahë zhvillimin e sektorit privat në arsim në të gjitha nivelet dhe do të zhvillojë politika të një konkurrence të fortë ndërmjet sektorit publik dhe atij privat, duke respektuar vlerat evropiane dhe ato botërore të arsimit.

LDK-ja vlerëson se duhet të promovohet shkenca dhe hulumtimet, të mbështeten projektet dhe publikimet e instituteve shkencore dhe të përkrahen hulumtimet shkencore të institucioneve të pavarura shkencore dhe të atyre të arsimit të lartë. LDK-ja e konsideron të një rëndësie të veçantë krijimin e një sistemi të integruar për shfrytëzimin efikas të krijimtarisë shkencore-hulumtuese të Kosovës dhe integrimin e Kosovës në Hapësinë Evropiane të Hulumtimeve.

LDK-ja do të angazhohet që cilësia dhe efektiviteti në arsim të rritet në të gjitha nivelet dhe të jetë e integruar, përfshirë edhe sistemin e trajnimit dhe atë të tranzicionit nga shkolla në punë kualitative me qëllim të krijimit të një force motivuese punuese me shkathtësi të lartë.

Karshi sfidave të globalizimit dhe vizionit për shoqëri të dijes do të sigurohet informatizimi dhe digjitalizimi i shkollave dhe do të krijohen standarde për vlerësim dhe monitorim të brendshëm të cilësisë së arsimit.

LDK-ja angazhohet për rritje permanente të buxhetit të arsimit, duke marrë parasysh popullsinë e re të Kosovës dhe nevojat më të mëdha për arsim. Pjesëmarrja e shpenzimeve për arsim në Bruto Produktin Vendor (BPV) dhe në shpenzimet e përgjithshme qeveritare duhet të sillet mbi mesataren evropiane, për shkak të specifikave demografike të Kosovës.

LDK-ja angazhohet për zgjidhjen e drejtë dhe avancimin e statusit të punonjësit të arsimit në të gjitha nivelet dhe të bëjë përmirësim rrënjësor të kushteve të punës.

## **VII. POLITIKA E JASHTME**

LDK-ja beson fuqishëm se forcimi i shtetit të Kosovës në dimensionin e brendshëm, do të reflektohet pozitivisht në dimensionin e jashtëm të tij dhe do të fuqizojë subjektivitetin e saj ndërkombëtar.

LDK-ja angazhohet në vazhdimësi për zhvillimin e kapaciteteve që do të sigurojnë kredibilitetin e Kosovës në skenën politike dhe ekonomike ndërkombëtare. LDK-ja beson se forcimi i shtetit të Kosovës është parakusht për arritjen e njohjes së plotë ndërkombëtare të Kosovës, anëtarësimin në mekanizma ndërkombëtarë, si dhe pjesëmarrjen në iniciativa rajonale shumëpalëshe.

Suksesi në procesin e njohjeve mund të arrihet vetëm me institucione të forta, efikase dhe të afta për të përfaqësuar interesat shtetërore ndërkombëtarisht dhe për ta arsyetuar luftën e drejtë të popullit të Kosovës për liri dhe pavarësi. Pjesëmarrja dhe anëtarësimi i Kosovës në organizma shumëpalësh mbetet prioritet për LDK-në. Anëtarësimi në organizata politike, ekonomike, kulturore, sportive, të sigurisë, etj., është synim i rëndësishëm i politikës së jashtme të LDK-së. Kjo do të mundësojë afirmimin dhe njohjen e Kosovës si subjekt sovran ndërkombëtar dhe përafrimin me përvojat ndërkombëtare.

LDK-ja angazhohet fuqishëm që Kosova, si një vend sovran dhe i pavarur, të kontribuojë në fuqizimin e bashkëpunimit rajonal, me qëllim të promovimit të stabilitetit dhe prosperitetit rajonal, në frymën e synimeve për integrim evropian. Fqinjësia e mirë dhe bashkëpunimi konkret rajonal janë vlera të promovuara dhe të kultivuara përherë nga LDK-ja dhe paraqesin themelin e dimensionit të ri ndërkombëtar të Kosovës.

Mbrojtja e interesave të Kosovës dhe të qytetarëve të saj, nëpërmjet anëtarësimit dhe pjesëmarrjes së institucioneve të Kosovës në organizatat politike dhe financiare ndërkombëtare, si dhe në forumet e tjera të rëndësishme, paraqesin themelin e vizionit të politikës së jashtme që do të udhëheqë LDK-ja. Kjo frymë është vazhdimësi e politikës mëse 20-vjeçare të LDK-së për afirmimin dhe mbrojtjen e interesave të Kosovës në planin ndërkombëtar. Promovimi i interesave politike dhe ekonomike të Kosovës, paraqesin përkushtimet e LDK-së për një imazh të ri ndërkombëtar të Kosovës.

Politika e jashtme e LDK-së dhe e Kosovës, që nga fillimi, është e lidhur me partnerin e përhershëm strategjik, Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Partneriteti forcohet me Bashkimin Evropian nëpërmjet procesit të integritimit. Politika e jashtme e LDK-së dhe e Kosovës duhet të jetë e koordinuar me Republikën e Shqipërisë, duke pasur parasysh interesat strategjike të shqiptarëve, në rajon dhe në Evropë.

## VIII. PROCESET INTEGRUESE

### **Integrimet evropiane dhe euroatlantike**

Kosova, si një shtet i ri evropian, ndihet pjesë e familjes evropiane dhe, si e tillë, kultivon vlerat e paqes, demokracisë, prosperitetit, zhvillimit dhe bashkëpunimit rajonal. LDK-ja angazhohet për arritjen e kriterëve të përcaktuara nga BE-ja për integrimin e Kosovës. LDK-ja e çmon rolin dhe përpjekjet e BE-së për të ndërtuar një Kosovë Evropiane. LDK-ja integrimin e Kosovës në BE e sheh si një projekt me rëndësi vitale për qytetarët dhe për shtetin e Kosovës dhe beson se procesit të 'evropianizimit' të Kosovës, duhet t'i prijë 'evropianizimi' i partive politike, institucioneve dhe shoqërisë kosovare.

LDK-ja beson se promovimi dhe krijimi i institucioneve profesionale dhe efikase, sundimi i ligjit, respektimi i të drejtave të njeriut dhe mbrojtja e pakicave, do ta përshejtojnë integrimin e Kosovës në BE dhe në NATO. LDK-ja angazhohet që shteti i Kosovës të zbatojë dhe të harmonizojë rekomandimet dhe politikat e BE-së, përmes kryerjes së obligimeve nga secili institucion shtetëror, në përputhje me kërkesat e 'Acquis communautaire'. LDK-ja angazhohet në dialogun për liberalizim të lëvizjes me BE-në.

Politika e LDK-së në raport me anëtarësimin e Kosovës në BE dhe NATO gjithashtu konsiston në bashkëpunim më të koordinuar me institucionet ndërkombëtare të vendosura në Kosovë. LDK-ja beson se integrimi i Kosovës dhe i Ballkanit Perëndimor në BE sjell paqe, prosperitet dhe stabilitet për këtë pjesë të Evropës.

### **Integrimet shqiptare**

LDK-ja, me Presidentin Rugova, e zhvilloi dimensionin politik të shqiptarëve në një program nacional, i cili synonte lirinë për vete dhe për të tjerët, jetën në paqe dhe harmoni. LDK-ja parimet e saj i mbështet në stabilitetin politik rajonal dhe në perspektivën integruese. Këto parime mbeten shumë aktuale edhe sot.

LDK-ja, që nga themelimi, ka promovuar politika demokratike në botën shqiptare. Edhe tash e në të ardhmen, LDK-ja do të promovojë integrimet demokratike shqiptare në të gjitha fushat e jetës: ekonomi, arsim, kulturë dhe politika të përgjithshme integruese që paqtojnë shqiptarët dhe rajonin tonë.

LDK-ja do të angazhohet për bashkëpunim të ngushtë me partitë politike shqiptare në Kosovë, në Shqipëri, Maqedoni, Mal të Zi, Medvegjë dhe Bujanoc, si dhe me bashkatdhetarët tanë jashtë vendit, për këmbimin dhe afirmimin e vlerave demokratike kombëtare, si pjesë të demokracisë evropiane. LDK-ja vlerëson thellimin e marrëdhënieve ndërshqiptare si faktor pozitiv në ruajtjen dhe kultivimin e traditës, historisë, gjuhës, feve dhe në këmbimin e këtyre vlerave me popujt e tjerë në Evropë dhe në botë.

## **IX. SHËNDETËSIA**

Si ndërtuese e një sistemi shëndetësor autentik, që mbajti gjallë për vite të tëra, gjatë okupimit, përkujdesjen për shëndetin e popullatës së Kosovës, LDK-ja e ka prioritet të lartë zhvillimin dhe avancimin e sistemit shëndetësor. Bazuar në standardet evropiane, LDK-ja promovon një sistem shëndetësor efikas dhe të mbështetur në resurse të qëndrueshme, që siguron qasje të barabartë në shërbime shëndetësore për të gjithë qytetarët.

Ulja e shkallës së sëmundshmërisë dhe vdekshmërisë, nëpërmjet ngritjes së cilësisë të shërbimeve shëndetësore, sipas standardeve bashkëkohore, është një synim parësor. Kosova ka nevojë të madhe për ngritje të kapaciteteve për kujdesin parësor shëndetësor, për edukimin shëndetësor të familjes dhe për implementimin e sistemit të informimit shëndetësor.

LDK-ja angazhohet për një menaxhim të integruar të shëndetësisë në të gjitha nivelet, me sisteme të qarta dhe efikase të referimit. LDK-ja vlerëson se Kosova ka nevojë për një master-plan që të sigurojë shpërndarje adekuate të infrastrukturës mjekësore dhe të kuadrit mjekësor në gjithë territorin e vendit. Ndërtimi i një sistemi informatik funksional për shëndetësi që integron të gjithë aktorët është hapi i parë drejt këtij master-plani.

Financimi i qëndrueshëm i shëndetësisë, do të sigurohet përmes zgjerimit të burimeve financiare, nëpërmjet shtimit të fondeve publike për shëndetësinë, aplikimit të skemës së sigurimeve shëndetësore, si dhe promovimit të partneritetit ndërmjet sektorit publik dhe atij privat. LDK-ja beson se skema e financimit duhet të reflektojë rritjen e cilësisë së shërbimeve, të cilat do të jenë të përballueshme për qytetarët.

LDK-ja angazhohet për integrim të tërësishëm të sistemit shëndetësor në të gjithë vendin si dhe arritje të standardeve ndërkombëtare sa i përket numri të personelit mjekësor në raport me popullatën. Krahas kësaj, LDK-ja angazhohet për avancimin e mjekësisë familjare për të targetuar sëmundjet që mund të eliminohet në mënyrë më efektive në fazat e hershme përmes edikimit më të mirë shëndetësor të familjes.

## **X. POLITIKAT SOCIALE DHE SOLIDARITETI NDËRSHOQËROR**

Si parti e qendrës së djathtë, LDK-ja promovon forcimin e ekonomisë së tregut dhe zhvillimin ekonomik si mjet kryesor për zbutjen e varfërisë dhe të papunësisë. Megjithatë, në një vend ku varfëria është e skajshme me afër gjysmën e popullsisë në varfëri, është i nevojshëm të sigurohet një solidariteti ndërshoqëror, përmes politikave ekonomike rishpërndarëse të të ardhurave. LDK-ja beson se zhvillimi dinamik dhe adaptimi në tregjet globale duhet të jetë kompatibil me parimin e përgjegjësisë sociale që ka shoqëria ndaj grupeve të caktuara, pasi në këtë mënyrë arrihet kohezioni i nevojshëm social dhe ekonomik, që siguron zhvillim të qëndrueshëm dhe afatgjatë.

Për të siguruar një mbrojtje sociale të qëndrueshme, skema e mbrojtjes sociale dhe pensionale duhet të organizohet në tri shtylla. Shtylla e parë ka të bëjë me ndërtimin e fondit të sigurimeve sociale, bazuar në kontributet e tatimpaguesve. Mjetet e këtij fondi

duhet të përdoren për të promovuar punësimin e të papunëve. Shtylla e dytë ka të bëjë me sigurimet pensionale, ku, përveç sigurimeve pensionale të obligueshme, promovohen edhe skemat e kursimeve vullnetare. Shtylla e tretë përfshin asistencën sociale që ofron shteti për më të varfërit, e cila duhet të sigurojë që familja, me mjetet që merr, plotësojnë nevojat elementare. Për aq sa është e mundshme, asistenca sociale do të kushtëzohet me punë aktive të përfituesve në punë të ndryshme publike dhe private, si dhe me pjesëmarrje në trajnime të ndryshme. Kjo është mënyra më e mirë për të zbutur varfërinë dhe për të zvogëluar varësinë nga asistenca sociale në afat të gjatë.

LDK-ja angazhohet të ndërtojë një skemë sociale të qëndrueshme financiarisht në afat të gjatë. Papunësia shumë e lartë ka bërë që numri i kontributdhënësve të jetë relativisht i vogël, krahasuar me numrin e përfituesve nga sigurimet sociale. Duhet të eliminohen në maksimum pengesat që dekurajojnë kompanitë të marrin femrat në punë dhe duhet të nxitet punësimi i personave të moshuar që ende nuk kanë arritur kohën e pensionimit.

LDK-ja angazhohet për politika aktive sociale dhe promovon ndërmarrësinë për të zvogëluar varësinë, nga skemat sociale. Prandaj, si mjet për zbutjen e papunësisë dhe të varfërisë dhe rrjedhimisht varësisë nga sigurimet sociale, do të promovohen iniciativat ndërmarrëse të të rinjve dhe të femrave. Kjo do të bëhet përmes krijimit të inkubatorëve të biznesit, skemave të financimit për biznese që themelohen nga grupe të marginalizuara, ofrimit të konsulencës dhe trajnimit për ndërmarrës të rinj dhe femra etj. Në zonat rurale në veçanti, zbutja e varfërisë dhe zvogëlimi i varësisë nga asistenca sociale do të bëhet përmes ofrimit të mundësive për zhvillim intensiv në bujqësi dhe stimujve të tjerë në fushën e kreditimit bujqësor. LDK-ja konsideron se kujdes të veçantë meritojnë punëtorë që ndikohen nga privatizimi i ndërmarrjeve shoqërore, në mënyrë që ata të mos bëhen barrë e asistencës sociale.

## **XI. VLERAT KULTURORE DHE SPORTET**

LDK-ja angazhohet për ruajtjen dhe promovimin e vlerave kulturore më përfaqësuese kombëtare dhe për këmbime të këtyre vlerave me komunitetin e madh evropian, në radhë të parë, por edhe me kulturat e tjera.

Në strategjinë e zhvillimit të kulturës, LDK-ja do të përfshijë komplementaritetet me Shqipërinë dhe trojet e tjera shqiptare. LDK-ja promovimin e vlerave kulturore brenda vendit do ta realizojë si nevojë shpirtërore, por edhe si nevojë të arsimimit kulturor, duke ruajtur dhe kultivuar identitetin kombëtar.

LDK-ja angazhohet të krijojë një model të ri qeverisës për kulturën, në përputhje me praktikën më të mira evropiane. Në menaxhimin e institucioneve lokale dhe qendrore kulturore dhe në vendimmarrjen e këtyre institucioneve, do të rritet pjesëmarrje e njerëzve të kulturës.

LDK-ja do të përkrahë dhe të nxisë krijuesit e rinj, organizatat profesionale dhe joprofesionale kulturore me qëllim të masivizimit të veprimtarisë kulturore. Forcimi i relacioneve me shtetet e tjera dhe i projekteve të përbashkëta, përmes së cilave promovohen vlerat kulturore të Kosovës dhe përmirësohet imazhi i vendin do të jenë me prioritet për LDK-në.

LDK-ja do të shtojë investimet në infrastrukturën kulturore dhe në rimëkëmbjen e institucioneve të kulturës në Kosovë. LDK-ja angazhohet për politika institucionale, të cilat afirmojnë dhe kultivojnë librin dhe veprimtarinë botuese, sidomos botimin e veprave kapitale të trashëgimisë nacionale të Kosovës dhe të shqiptarëve në përgjithësi.

LDK-ja angazhohet që, përmes sportit, të përfaqësohet dhe të afirmohet shteti i Kosovë në botë, si dhe të forcohet kohezioni nacional. LDK-ja angazhohet për masivizimin e sportit përmes investimeve në infrastrukturën sportive, në mbështetjen e iniciativave të të rinjve dhe të talentëve të rinj. Do të promovohet sporti shkollor dhe universitar. Do të përkrahet masivizimi i sportit. LDK-ja angazhohet në zhvillimin e sistemit të sportit në përputhje me Kartën Evropiane të Sportit dhe Kodit të Etikës në Sport dhe promovon pjesëmarrjen në sporte dhe në gara ndërkombëtare.